



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2019:084905 C. nr. 1018/2017
Datë: 30.12.2019
Numri i dokumentit: 00740999

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me praktikanten E. K, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditëses B.K.S në Prishtinë, Rr. “..., Magj. Prishtinë-Fushë Kosovë”, kundër të paditurit Sh.H nga Prizreni, Rr. “...”, nr...., për shkak të regresit, jashtë seance me datë 30 dhjetor 2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M
(për shkak të mosbindjes)

Miratohet kërkesëpadia e paditëses B.K. S.

Detyrohet i padituri Sh.H nga Prizreni, që paditëses B. K.S, në Prishtinë, në emër të regresit, t’i rimburojë shumën 400.00 €, me kamatë vjetore 8% nga data 17 Gusht 2017 (datë e parashtrimit të padisë), deri në pagesën definitive. Si dhe të paguan shpenzimet e procedurës në shumën 20,00 €, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 17 Gusht 2017 ka paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyrohet i padituri në emër të regresit të rimburoson shumën e dëmit të cilin paditësja i ka paguar personit të tretë, përkatësisht L.B nga

Padisë i ka bashkangjitur si prova materiale: Raportin e aksidentit nr. ... i datës 12.08.2014, konfirmimi i policës siguroese, ujdinë jashtëgjyqësore e datës 13.11.2014, urdhër transferin bankar i datës 16.11.2014.

Gjykata një kopje të padisë dhe provave të bashkangjitura padisë i ka dorëzuar palës së paditur me vërejtje për dhënien e përgjigjes në padi, duke e udhëzuar palën e paditur që të paraqet përgjigje me shkrim në padinë e palës paditëse. Ndërsa në anën tjetër edhe e ka njoftuar për pasojat e mosveprimit sipas asaj vërejtje.

Në kuptim të nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, personi i dëmtuar nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, brenda territorit të Republikës së Kosovës, ka të drejtë që nga B.K.S të kërkojë dëmshpërblim. Në rastin konkret i dëmtuari L.B, si person i dëmtuar nga ai aksident, me ujdinë jashtëgjyqësore është kompensuar nga B.K.S në shumën e përgjithshme 400,00 €, pasi që, i padituri Sh.H, si pronar i automjetit të tipit ..., me targa të regjistrimit ...,

nuk ka pasur mbulesë të sigurimit nga auto përgjegjësia, pasi që e njëjta ka qenë e skaduar në afat.

Për shumën e paguar në emër të kompensimit të dëmit, për të dëmtuarin L.B, Byroja Kosovare e Sigurimeve, në kuptim të nenit 18 par. 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, përmes padisë ka kërkuar që atë shumë ta regreson nga i padituri.

Pasi që pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi si dhe duke pasur parasysh faktin se themelësia e kërkesë padisë del nga faktet e treguara në padi dhe të njëjtat nuk janë në kundërshtim me provat e administruara, gjykata në kuptim të nenit 150 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të miraton kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjykata vendosi që pala e paditur të paguan kamatën vjetore prej 8 % nga data 17 Gusht 2017, deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke miratuar shumën prej 20,00 € për taksa gjyqësore për padinë e paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr.1018/2017 datë 30 Dhjetor 2019

Praktikantja
E. K

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi.